Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara
Coalition for Reforms, Integration and Consolidated Institutions

Contact: **Mobile/Whatsapp:** + 355 673890174; 682039297 | **Email:** info@kriik.al; info.kriik@gmail.com | **Web:** www.kriik.al | **Facebook** : https://www.facebook.com/kriik.al |

Nr. 2305/42 K (e-k) Prot.
Tiranë, më datë 10/05/2023

Drejtuar: **Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
z. Ilirjan CELIBASHI

Për dijeni: **Subjekteve Zgjedhore garuese në Zgjedhjet Vendore të 14 majit 2023**

Misionit të OSBE/ODIHR në Tiranë

Trupit Diplomatik dhe Organizatave Ndërkombëtare me seli në Tiranë

Lënda: **KËRKESË – Për njoftimin sërish të mediave dhe subjekteve zgjedhore lidhur me mostransmetimin e sondazheve zgjedhore jashtë afatit të lejuar nga ligji dhe respektimin e heshtjes zgjedhore.**

I Nderuar Z. Komisioner!

Të nderuar Kolegë të Administratës së KQZ-së!

Kodi Zgjedhor, në nenin 78 "Të drejtat dhe detyrimet e subjekteve zgjedhore gjatë fushatës" pika 4 përcakton se "*Rezultatet e sondazheve zgjedhore nuk mund të publikohen gjatë 5 ditëve të fundit para datës së zgjedhjeve, përfshirë edhe datën e zgjedhjeve deri në orën e mbylljes së votimit*".

Në funksion të respektimit dhe përcaktimit të qartë të kësaj pike, KQZ publikoi në faqen e saj zyrtare në rrjetet sociale lajmërimin për datën e përfundimit të këtij afati, duke qartësuar **se ndalohet publikimi i sondazheve nga data 9 maj deri në përfundim të procesit të votimit.** Pra, sikurse është bërë e qartë, sondazhet mund të transmetoheshin deri në datën 8 maj 2023.

Lidhur me këtë çështje KRIIK konstatoi në faqen e internetit të Televizionit "Report TV" lajmërimin për publikimin e rezultateve të një sondazhi në datën 9 maj, ç'ka ishte në tejkalim të afatit ligjor.

Për këtë KRIIK njoftoi dhe komunikoi verbalisht me administratën e KQZ, duke parashtruar nevojën për marrjen e masave të nevojshme për lajmërimin e këtij subjekti mediatik audio-viziv për të mos transmetuar sondazhin, si dhe për të mos ta vendosur organin mediatik në kushtet e shkeljes ligjore.

Address:
Rr. "Ymer Kurti", Nd.4, H.2, Ap.3, Nj.Adm.5, Tirana


Mailing address:
P.O.Box. 2396 Tirana, 1001, Albania

Contact: **Mobile/Whatsapp:** + 355 673890174; 682039297 | **Email:** info@kriik.al; info.kriik@gmail.com | **Web:** www.kriik.al | **Facebook** : https://www.facebook.com/kriik.al |

Nga monitorimi i bërë, rezultoi se ky sondazh u transmetua në datën e paralajmëruar prej televizionit Report TV në mbrëmje, në shkelje të afatit ligjor të lejuar (gjeni më poshtë foto të transmetimit televiziv të kryer).



Gjithashtu rezultoi se, përpos Report TV, po në mbrëmjen e datës 9 maj 2023 edhe në televizion KLAN, në emisioni Opinion, u transmetuan të përmbledhura rezultate të sondazheve të zhvilluara në herët nga televizione të tjera, duke shkelur afatin e lejuar nga Kodi Zgjedhor (gjeni më poshtë foto të transmetimit televiziv të kryer).



Bazuar në sa më sipër, në gjykimin e KRIIK , **nevojitet që KQZ-ja ta marrë në konsideratë dhe shqyrtojë shkeljen, me qëllim njoftimin dhe këshillimin publik të mediave respektive**, si një mënyrë e drejtëpërdrejtë dhe efikase për të evidentuar qartazi se asnjë aktor publik, qoftë ky edhe një media, nuk është mbi ligjin.

Address:
Rr. "Ymer Kurti", Nd.4, H.2, Ap.3, Nj.Adm.5, Tirana
Mailing address:
P.O.Box. 2396 Tirana, 1001, Albania

Kjo qasje konsiderohet veçanërisht e nevojshme për të sensibilizuar dhe rritur përgjegjshmërinë në vazhdim të të gjithë organeve mediatikë, veçanërisht atyre audio-vizive, qofshin këto qëndrore apo lokale.

Sjellim në vëmendje të KQZ-së se mediat lokale nuk monitorohen 100% nga AMA e në përgjithësi janë shumë më pak në kontroll e monitorim.

Nisur edhe nga përvoja në zgjedhjet e mëparshme, me shumë gjasë gjetjet apo pjesë nga këto sondazhe mund të përsëriten e publikohen edhe në vazhdim, duke shkelur ligjin dhe shkaktuar pasojat respektive në objektivitetin e votuesve.

Gjykohet dhe nxitet KQZ, të **komunikojë në vazhdimësi me këto media, dhe me të tërë mediat në vend, si edhe me AMA-n, për të informuar mbi këtë ndalim dhe ndërgjegjësuar për të ndaluar publikimin e sondazheve në vijim, apo edhe çdo ri-publikim të pjessshëm apo të plotë të gjetjeve të tyre.**

Gjithashtu, gjykohet me vend që në funksion të informimit mbi ndalimet e ligjit dhe respektimin e tij, **të gjitha mediat duhet të informohen e ndërgjegjësohen lidhur me respektimin e heshtjes zgjedhore,** duke përfshirë në sferën e shkeljeve edhe rastet e ri-transmetimit të lajmeve më të hershme që kanë lidhje me fushatën zgjedhore.

Së fundmi, në linjë me ruajtjen e heshtjes zgjedhore dhe referuar përvojave të hasura në zgjedhjet e mëparshme, KRIIK evidenton se në ditën e zgjedhjeve **subjektet zgjedhore kanë praktikën të vijojnë reklamat me pagesë, qoftë në faqe interneti, qoftë në mediat sociale apo ne mediat e tjera online**.

KRIIK gjykon se është me vend dhe nxit KQZ-në ta shqyrtojë këtë fenomen duke e konsideruar këtë lloj reklame në çdo platformë online të njëvlefshme me reklamën e ndaluar në mediat audio-vizive.

KQZ-ja duhet t'u kujtojë subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve të tyre se gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore të gjitha reklamat online, qofshin ato në faqe interneti (pra në media online), qofshin në mediat sociale (të tilla si Faceook, Instagram, YouTube, etj) **duhet të mos jenë aktive e të mos transmetohen**, sikurse ka ndodhur më parë.

Kodi Zgjedhor parashikon periudhën e heshtjes zgjedhore si një periudhë në të cilën qytetarët shqiptarë nuk duhet të ndikohen në asnjë mënyrë dhe në asnjë rast nga propaganda elektorale, në çdo formë dhe mjet me të cilën mund të shfaqet e transmetohet ajo.

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi,

Me konsideratë,

Për **Koalicionin Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

Premto Gogo
Kryetar

Address:
Rr. "Ymer Kurti", Nd.4, H.2, Ap.3, Nj.Adm.5, Tirana

Mailing address:
P.O.Box. 2396 Tirana, 1001, Albania